# DËSHMI ARKIVI

**A-474128**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Takimi me Lavrov në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme/ Wadephul: Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin |
| ADRESA | `https://dosja.al/bota/takimi-me-lavrov-ne-kuader-te-asamblese-se-pergjithshme-wadephul-shte-e-dre-i516353` |
| BURIMI | dosja.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 27 shtator 2026, 15:15:52 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 27 shtator 2026, 15:02:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `39a80a0bf48b20f0106cfa8993448d0aa702c8e9037684847a95fb2903805317` |
| TEKSTI | `8f8df94f43f40a0ebcb0276cc1d496f8a9b21732069ac29d159cb97f3e628166` |
| PAMJA | `2ab9cb8b2d38b3d9277a3454392dd832037a4ad5e8a3666f7d23f9fcf64509ec` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `3e1a09da6a05bfc5e8a4b9e89841a0cd59c499623a3d718387813de723b7ec69` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `3dbf5264f26ae921c8f8735760cb378b1b626a14b73f487ffe641eb8f02fca55` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/3e1a09da6a05bfc5e8a4b9e89841a0cd59c499623a3d718387813de723b7ec69`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Bota

# Takimi me Lavrov në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme/ Wadephul: Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin

Biseda, që zgjati rreth 20 minuta dhe ishte takimi i parë dypalësh midis ministrave të Jashtëm të të dy vendeve pas disa vitesh, u organizua, sipas Wadephulit, me ndërmjetësimin e palëve të treta.

dosja
27 Shtator 2026, 17:02
Nga G.M



Takim 20 minuta i ministrit të Jashtëm gjerman, Wadephul dhe atij rus, Lavrov në kuadër të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së

Ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Johann Wadephul, është takuar papritur me homologun e tij rus, Sergej Lavrov, në kuadër të debatit të përgjithshëm të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së në Nju Jork. Biseda, që zgjati rreth 20 minuta dhe ishte takimi i parë dypalësh midis ministrave të Jashtëm të të dy vendeve pas disa vitesh, u organizua, sipas Wadephulit, me ndërmjetësimin e palëve të treta.

*"Jam kontaktuar nga shumë kolegë të vendeve të tjera dhe më është thënë se Rusia ishte e gatshme për një bisedë"*, tha ministri i Jashtëm gjerman në një intervistë për emisionin gjerman të ARD-së, tagesthemen. Sipas tij, shumë prej tyre e këshilluan ta zhvillonte këtë takim dhe madje ia kërkuan një gjë të tillë.

**"U kalua një vijë e kuqe"**

Përmbajtja e bisedës u përqendrua te pasojat e luftës agresive të Rusisë kundër Ukrainës. Sipas Wadephulit, një nga çështjet kryesore ishte eksporti i drithërave nga Ukraina dhe Rusia.

*"Një vend si Egjipti ka nevojë urgjente për diçka të tillë. Ekziston rreziku i urisë"*, tha ministri gjerman i Jashtëm. Angazhimi për të garantuar këto eksporte është, sipas tij, gjëja e duhur për t'u bërë.

*"Një dron, i cili realisht mund të kishte shkaktuar rrëzimin e avionëve, është vënë në përdorim atje nga duar ruse"*, tha Wadephul.

Ai theksoi se ia kishte bërë të qartë Lavrovit se "me këtë është kaluar një vijë e kuqe" dhe se Gjermania pret që një gjë e tillë të mos përsëritet.

*"Ne jemi gjithmonë të gatshëm të reagojmë"*, paralajmëroi ministri gjerman i Jashtëm.

editoriale

Auron Janku
"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli
Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 15:07
Reforma në Drejtësi/ Rama: Pa mua, SHBA-ja dhe BE-ja do kishin bërë Noc Rrokun

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:45
Xing në Rinas/ Rama vjen nga SHBA, Berisha largohet për në Strasburg (VIDEO)

Qeveria federale gjermane e konsideron Rusinë përgjegjëse për incidentin me një dron të pajisur me lëndë shpërthyese që nuk arriti të shpërthejë në aeroportin Leipzig/Halle, një nyje logjistike me rëndësi të madhe për mbështetjen e Ukrainës.

Sipas Berlinit zyrtar, droni paraqiste një rrezik serioz për trafikun ajror dhe mund të kishte shkaktuar pasoja të rënda. Autoritetet gjermane e lidhin incidentin me veprime ruse dhe e shohin atë si një përshkallëzim të papranueshëm. Së treti, Wadephul tha se i kishte bërë të qartë Lavrovit se mbështetja gjermane për Ukrainën mbetet e palëkundur.

*"Kjo mbështetje është plotësisht e pandërprerë"*, theksoi ministri i Jashtëm gjerman, duke shtuar se tani është Rusia ajo që duhet të ulet në tryezën e negociatave.

*"Nuk ka asnjë justifikim për këtë luftë, e cila po merr jetë të panumërta njerëzish, përfshirë edhe viktima ruse, por mbi të gjitha viktima civile në Ukrainë"*, deklaroi Wadephul.

**Jo ndryshim i politikës së jashtme gjermane**

Sipas ministrit të Jashtëm gjerman, ndërsa Gjermania do të vazhdojë të mbështesë Ukrainën përballë agresionit rus.

*"Është e drejtë që ne të flasim me njëri-tjetrin"*, tha më tej Wadephul. Sipas tij, Rusia aktualisht nuk është e gatshme t'i japë fund luftës kundër Ukrainës.

*"Megjithatë, unë besoj se është e drejtë që ne të vazhdojmë të bisedojmë me njëri-tjetrin. Kjo është detyra e ministrive të jashtme dhe e diplomacisë"*, theksoi ministri i Jashtëm gjerman.

Pranimin e një bisede të drejtpërdrejtë me Lavrovin, Wadephul nuk e sheh si një ndryshim të kursit në politikën e jashtme gjermane. Gjermania vazhdon të mbrojë të drejtën ndërkombëtare dhe të qëndrojë në krah të Ukrainës. Këtë qëndrim, tha ai, ia bëri të qartë edhe një herë ministrit të Jashtëm rus gjatë takimit.

*"E dini, me miqtë nuk negociohet, ndërsa me kundërshtarët duhet të negociohet. Ky është një nga parimet themelore të politikës së jashtme dhe ai vlen edhe në këtë rast"*, tha Wadephul.

Ministri i Jashtëm rus, Sergej Lavrov, e vuri menjëherë në pikëpyetje dobinë e takimit dhe tha se nuk kishte parë asnjë përparim konkret. Në një deklaratë për agjencinë gjermane të lajmeve dpa, Lavrov u shpreh se nëse shihen deklaratat e përditshme publike të Berlinit, nuk kam dëgjuar asgjë ndryshe. Sipas tij, qëndrimet e paraqitura nga pala gjermane ishin tashmë të njohura dhe nuk sollën asgjë të re.

"Mund të më kishin telefonuar thjesht", shtoi kryediplomati rus.

**Fjalim mbi rreziqet e inteligjencës artificiale**

Wadephul kishte udhëtuar në Nju Jork si përfaqësues i kancelarit federal Friedrich Merz. Në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, ai u përqendrua te rreziqet që vijnë nga zhvillimi jashtëzakonisht i shpejtë i inteligjencës artificiale.

Ministri i Jashtëm gjerman paralajmëroi se përparimi i vrullshëm i teknologjive të inteligjencës artificiale sjell jo vetëm mundësi të mëdha, por edhe sfida serioze për sigurinë, stabilitetin dhe rendin ndërkombëtar.

*"Së bashku, vendet anëtare të Kombeve të Bashkuara duhet të sigurojnë që inteligjenca artificiale t'i shërbejë dinjitetit njerëzor"*, theksoi Wadephul në fjalimin e tij para Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së./DW

johann wadephul sergej lavrov okb dw

POLITIKE 27 SHTATOR 2026, 13:38

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

## më të klikuarat

Rama sulmon 2 televizione: Lavatriçe mediatike, kanë marrë peng një Prokurori

Çfarë po ndodh në Rinas? Rama lë gazetarët jashtë dhe anulon konferencën, video-mesazhi shpërndahet me regji nga Kryeministria

Shpresë për familjen Kotorri/ Emisioni italian publikon foton e ngjashme me Rajmonda Kotorrin që u zhduk 16 vjeçe në Itali

Shisnin drogë pranë shkollave në Tiranë, goditen disa grupe! 31 të arrestuar, 14 të tjerë në kërkim (VIDEO)

## insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

## Moti

Powered by tomorrow.io

## Sondazh

Poll

Bota

27 Shtator 2026, 16:56

# Skenar lufte! Lituania teston evakuimin në rast sulmi, mijëra zyrtarë përfshihen në stërvitjen kombëtare

Foto ilustruese LITUANI- Lituania ka nisur një stërvitje të gjerë për përgatitjen ndaj një krize të mundshme të...

---

### Ngjarja në RAF Fairford/ Analizë: Të gjithë skenarët pse u dha alarmi në bazën më të madhe amerikane të bombarduesve në Evropë

Bota

27 Shtator 2026, 16:40

---

### VIDEO/ 'Ferri në Tokë' në Oleshki, banorët ushqehen me bimë të egra për të mbijetuar

Bota

27 Shtator 2026, 16:32

---

### VIDEO/ Sulm pranë një tregu në Jemen, raportohen shtatë viktima dhe 40 të plagosur

Bota

27 Shtator 2026, 16:27

---

### Alarm sigurie/ Agjentët e OpenAI skanojnë mbi 16 mijë herë faqen e OKB-së, anashkalojnë kufizimet

Bota

27 Shtator 2026, 16:14

---

Bota

27 Shtator 2026, 16:08

# Alarm pranë bazës RAF Fairford, arrestohen pesë persona nën dyshimin për terrorizëm

RAF Fairford BRITANI E MADHE- Pesë persona janë arrestuar nga autoritetet britanike nën dyshimin se po përgatitnin një akt terrori...

---

### “Nuk është çështje ideologjie”/ Sanchez për krizën e emigrantëve në Ceuta: Po punojmë intensivisht, është çështje njerëzimi

Bota

27 Shtator 2026, 15:56

---

### Rusia sulmon Ukrainën, teksa Zelensky thotë se Moska s’është e gatshme t’i japë fund luftës

Bota

27 Shtator 2026, 15:31

---

### Arrestime pranë bazës ajrore britanike të përdorur nga SHBA-ja në luftën me Iranin

Bota

27 Shtator 2026, 15:29

---

### Kongresisti republikan i kërkon Partisë Popullore Evropiane t’i ndërpresë lidhjet me partinë e Vuçiç: Të ketë zgjedhje të lira në Serbi

Bota

27 Shtator 2026, 14:18

**MË SHUMË**






Rama: S’ka një provë të vetme që një bir nëne të ketë një qindarkë të tijen në xhepin tim



Qytetarët kërkojnë dorëheqjen, Rama: Asgjë nuk do të më ndalë




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.